



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS GJERMANE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Përkthim A-B (moduli 2)

Ngarkesa: 3 kredite, 30 orë seminari

Viti akademik, semestri kur zhvillohet: Viti i parë, semestri II

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Master shkencor në “Përkthim teknik-letrar dhe Interpretim”

PËRMBLEDHJE E LËNDËS DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore: Studentët e programit të masterit duhet të zhvillojnë aftësitë e tyre përkthyes në një nivel më të lartë në disa rrafshë si p.sh: të kuptuarit e tekstit origjinal, përkthimi i tekstit të synuar si dhe redaktimi. Ata gjithashtu duhet të rrisin shpejtësinë dhe cilësinë e përkthimit të tyre. Objektivat e përgjithshme lëndore: Ky kurs synon t’u mprehë studentëve aftësitë përsa u përket vështirësive që hasen në përkthimin e teksteve të zhanreve të ndryshme (politike, shoqërore, kulturore, turistike, filologjike, etj.), me qëllim që ata të jenë të aftë që pas një analize të mirëfilltë shumëplanëshe (pragmatike, leksikore dhe terminologjike, gramatikore dhe stilistikore) të zhvillojnë strategji në nivel mikro dhe makro për të sintetizuar tekstin në gjuhën mbërritëse, duke njohur karakteristikat specifike të këtyre teksteve. Në përfundim të kursit studentët do jenë të aftë t’u përgjigjen sfidave që parashtron përkthimi i teksteve të sipërpërmendura për kombinimin gjuhësor A-B. Ata do të dinë të përdorin hap pas hapi instrumentet e duhura në të përditshmen profesionale.

Objektivat specifike;

Kjo është një lëndë e detyrueshme dhe synon t’u japë studentëve njohuri bazë mbi termat e përdorura në tekstet paralettrare të gjuhëve A dhe B si edhe t’i aftësojë ata në përkthimin e këtyre teksteve. Lënda synon t’i nxitë studentët të kryejnë punë kërkimore dhe terminologjike duke punuar me dokumenta origjinalë, fjalorë terminologjikë, enciklopedi, si edhe me internetin.

Rezultatet të pritshme:

1. Të arrijë të marrë njohuritë bazë të përkthimit.
2. Të njohë teknikat e nevojshme për studimin e tematikës së lëndës.
3. Të mësojë të kërkojë dhe të organizojë e sistemojë informacionin gjuhësor të lëndës.